



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr. 5908 / 18 Prot.

Divjakë më 16.07. 2026

THIRRJE

“PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS TË KËSHILLIT BASHKIAK
DIVJAKË, MUAJI KORRIK, 2026”

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijeni:

KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma (a) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, **Ju njoftojmë se:** Më datë: **24 .07. 2026, ditën e Premte , ora 10:00,** tek Salla e mbledhjeve, kati i dytë, në Godinën e Bashkisë Divjakë, thirret “Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Korrik 2026”. **Me këtë Rend dite:**

- 1.Miratim i Rendit të Ditës.
- 2.Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 06.07.2026.
- 3.Informacion mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Qershor, 2026.
- 4.**Projekt-vendim Nr.63,datë, 10.07.2026:** Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6%, për muajin Qershor, 2026.
- 5.**Projekt-vendim Nr.64,datë,13. 07.2026:** Mbi miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK, pranë Drejtorisë Vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para noterit.
- 6.**Projekt-vendim Nr.65,datë,14. 07.2026:** Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Divjakë.
- 7.**Projekt-vendim Nr. 67.datë, 14. 07. 2026:** Për miratimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar, në programin “ Emergjencat civile” për vitin 2026.
- 8.**Projekt-vendim Nr. 69.datë, 16. 07. 2026:**Mbi anulimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 57 datë 26.06.2026 “ Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar shtetasve të cilëve u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme”
9. **Projekt-vendim Nr. 70.datë, 16. 07. 2026:** “ Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar shtetasve të cilëve u janë dëmtuar banesat nga fatkeqësi të ndryshme”

Sqarim: Komisionet përgjegjës sipas pikave në Rendin e ditës janë:-Komisioni i Ekonomisë dhe financave, për pikat nr: **4,6,7,8,9.** Komisioni i Urbanistikës, Infrastrukturës dhe Strehimit, për pikat **5,** Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, emergjencave civile, për pikën **7.**

Duke ju falenderuar !

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Liri Biri

